



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE E GJELBËRIMIT

Nr. Prot

Tiranë më,03.11.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM
TE KONTRATES ME OBJEKT PROKURIMI
“BLERJE MJETE TRANSPORTI” PËR NEVOJAT E DPPGJ PER VITIN 2022**

OBJEKTI PROCEDURËS: “BLERJE MJETE TRANSPORTI”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): FPP)
(Mjete transporti te dores se dyte)

VLERA E FONDIT LIMIT: 9 990 000 (nente million e nenteqind e nentedhete mije) lekë (**pa TVSH**) me burim financimi buxhetin afatmesem 3 vjecar 2022-2024.

I mbajtur sot më date **03.11.2022**, në DPPGJ – Tirane, në prani të anëtarëve të Njesisë së Prokurimit të ngritur me Urdhër të Titullarit të AK, për miratimin e dokumentave të tenderit « Tender i hapur i thjeshtuar», bazuar në nenin 55 te VKM 285 dt. 19.05.2021 si dhe nenit 49 te Ligjit 162/2020 «Per Prokurimin Publik» me mjete elektronike, me afat 15 ditë nga data e lidhjes se kontrates mbi **sasinë e mallrave të cilat kërkohet të kontraktohen sipas tabelës si më poshtë vijon:**

SASIA E MALLIT

Përshkrimi i mallit	Copë
<i>Kamionçinë vet-shkarkuese e mbyllur hermetikisht me hapje anësore për grumbullim mbetjesh me kapacitet 5m³ – 6m³.</i>	1
<i>Kamionçinë vet-shkarkuese elektrike e mbyllur hermetikisht me hapje anësore për grumbullim mbetjesh.</i>	1

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Malli sipas preventivit të mësipërm do të dorëzohen në oficinën e blerësve në adresën Rruga 5 “Maji” Tirane		DPPGJ	15 dite nga lidhja e kontratës

Per objektin në referencë.

Njësia e Hartimit të Dokumentave, në hartimin e dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi, është mbështetur tek grupi i punës i ngritur për hartimin e nevojave, specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe kriterëve të veçanta teknike, të procedurës në referencë.

Gjithashtu NJP është bazuar në nenin 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenin 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e nevojave, specifikimeve teknike, fond limit dhe kriterëve të veçanta teknike.

Data e hapjes së ofertave planifikuar date 14.11.2022 Ora: 11:00

- www.app.gov.al
- *Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip.*
- *Dokumentat pa pagesë.*

Njësia e prokurimit, bazuar në parashikimet ligjore dhe në objektin e prokurimit, vendosi kriteret e kualifikimit, të cilat gjejnë pasqyrim në Shtojcën 7 të DST –ve, kriteret, të cilat u konsideruan si të nevojshme për përmbushjen e kontratës, në përpjestim me përmasat dhe veçoritë e objektit që prokurohet dhe konkretisht, si më poshtë vijon:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi/Kualifikimit, janë të pa ndryshueshme nga ato të miratuara nga APP në setin standart të dokumentave të tenderit.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT të pa ndryshueshme nga ato të miratuara nga APP në setin standart të dokumentave të tenderit.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3, ne masen 2% te e vlerës së përlogaritur të kontratës ne nje nga format e parashikuara ne ligjin nr.162/2020 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” konform nenit 83.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarim, sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimeve bazuar në natyrën dhe përmasat e kontratës, specifikimet teknike , grafikun e lëvrimit të mallit, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, te cilat jane argumentuar dhe vendosur nga grupi I punes I ngritur per kete arsye,me qëllimin kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht si vijon :

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiroën e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ushtrimore (2019,2020,2021) **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës** te procedures se prokurimit, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit, të kontrates qe prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 1 dhe 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjykojnë me të arsyeshme të sjellin edhe vërtetimin.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor

për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) 'Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik', si dhe pika 6 e këtij neni: 'Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin'.

2.2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve te fundit ushtrimore (2019,2020,2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet shoqëruar me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c", të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklarata për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjykojnë me të arsyeshme të sjellin edhe bilancet.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) 'Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik', si dhe pika 6 e këtij neni: 'Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin'.

2.2.3 Një dokument që vërteton se (subjekti) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet dhe detyrimet e maturuara për vitin 2022, sipas të dhënave të QKB-së.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore,” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB,” i ndryshuar.

2.3.Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës** të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4 si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **20% të vlerës së fondit limit**, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Argumentimi si më lart.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

Kritere të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik, janë argumentuar nga grupi i punës, specialistet e fushes nisur nga natyra dhe permasat e kontrates, specifikimet teknike, grafiku i levrimit, fushes se veprimtarise se institucionit, konkretisht si vijon:

Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) ‘Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, si dhe pika 6 e këtij neni: ‘Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin’.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Deklaratë garancie jo më pak se **12 (dymbëdhjetë muaj)** për mallrat objekt prokurimi. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u garantuar se për një periudhë të arsyeshme prej 12 muajsh nga dita e furnizimit të mallrave objekt prokurimi do të përmbushin specifikimet teknike dhe do të mbulohen të gjitha problematikat që mund të lindin, por jo për faj të Autoritetit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 9001:2015**, ose ekuivalente. *Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH*".

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77,79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

ISO 9001:2015 "Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë" – Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruara janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 9001 është standardi më popullor i publikuar në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë të cilat mund të implementohen dhe certifikohen nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensionit të saj apo fushës së aktivitetit. Kërkesat e **ISO 9001:2015** i referohen aspekteve të ndryshme siç janë: implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve. Certifikimi ISO 9001 përfaqëson një konfirmim të faktit që shoqëria respekton një seri kërkesash të pranueshme në nivel ndërkombëtar. Mbajtja e certifikimit sjell disa përparësi për shoqërinë siç janë: akses tek procedurat e tenderave publike, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë llojin e mjeteve, të shoqëruara me librezën përkatëse dhe me foto për secilin, në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike të mjeteve me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. Gjithashtu duhet të deklarohen edhe kilometrat e bëra për çdo mjet, të shoqëruar edhe me foto të treguesit të kilometrazhit në kroskot për secilin prej tyre.

Argumentim: Ky kriter është bazuar në nenin 77 te ligjit 162/2020 "Per Prokurimin Publik" menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues qe do të paraqesë mallra, per të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me librezën

përkatëse dhe foton e secilit mjet, është vendosur në përputhje me Nenin 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar **inxhinier Mekanik** ne stafin teknik, të përfshirë në licensën e shoqërisë i pajisur me dëshmi aftësie profesionale lëshuar nga Ministria Transportit dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e muajit të fundit për të cilin duhet të paraqitet kontrata e punës, diploma si dhe listëpagesat e shoqërisë, ku të figurojë i regjistruar inxhinieri i sipërpërmendur.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 germa a dhe b si dhe pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratës. AK vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në këtë rast dëshminë e punësimit të një Inxhinieri Mekanik, kjo duke marrë parasysh faktin se AK ka kërkuar një garanci 12 (dymbëdhjetë) mujore për mjetet dhe rrjedhimisht OE i kontraktuar duhet të mbajë përgjegjësi për çdo defekt që nuk vjen si pasojë e drejtuesit të mjetit apo të mosmirëmbajtjes së tij.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht, **1(një) Automakinist**, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për periudhën e muajit të fundit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 germa a dhe b si dhe pika 8, të VKM nr.285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave. Specifikisht ky kriter është vendosur pasi referuar specifikimeve teknike dhe faktit se OE fitues duhet që përpara se të dorëzojë mallin (kamionçinat vetë-shkarkuese) duhet të administrojë një sërë praktikash, referuar nxjerrjes së dokumentacionit si vijon: Certifikatë pronësie, leje qarkullimi, kolaudim, dhe policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjeshinë ndaj paleve te treta (TPL), në emër të blerësit ‘Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit’, këto me shpenzimet e subjektit ofertues. Duke patur parasysh që kërkesa e AK i referohet llojit të mjeteve (kamionçina vetë-shkarkuese), specifikojmë se për të lëvizur këto lloj mjeteve duhet që drejtuesi i mjetit të jetë i pajisur me dëshmi auto-makinisti. Gjithashtu theksojmë se kërkesa në fjalë i referohet: Urdhër Nr. 200, Datë 16.5.2019 Për Miratimin e Rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë marrëveshje ose kontratë me shitësin ose distributorin të Autorizuar prej saj (në rastin e autorizimit të distributorit, duhet të paraqesë një letër angazhimi ose akt marrëveshjen midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre) të shoqëruar me specifikime teknike të mjeteve dhe Foto, në rast se kontrata ose marrëveshja është me shites ose distributore të huaj duhet të jetë e perkthyer dhe e noterizuar në gjuhën shqipe. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si telefon, fax, email, website Automjetet duhet të jenë të prodhuara në Bashkimin Europian.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenin 40 pika 6 të VKM 285 dt. 19.05.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet

drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa që mjetet të jenë të prodhuara brënda BE i referohet faktit se pjesët e këmbimit janë më të aksesueshme dhe koha referuar transportit të pjesëve të këmbimit është relativisht më e shpejtë kur mjetet janë të prodhuara në BE.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të disponoj ose të paraqesi kontratë bashkëpunimi me servis të specializuar për riparimin e mjeteve të transportit brenda afatit të garancisë. Për të vërtetuar këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë edhe foto të ambienteve të brëndshme të reparteve të punës.

Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të mbulimit të garancisë, operatori ekonomik duhet të ketë te paraqes listën e serviseve në pronësi ose me qera të cilat detyrimisht duhen të jene te pajisur me dokumentacion si me poshte:

- Licencën e kategorisë VII.3.B.1, “Riparimi dhe mirembajtja e pjesëve mekanike dhe te motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, pikat a,b,c në përputhje me legjislacionin, për lejet dhe licencat, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet;
- Kontratën e qerasë/huapërdorjes në rast se është në kushtet e qerasë apo huapërdorjes.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të nenit 40 pika 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”,

“j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar , si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mjeteve do t'i shoqërojë ato me:

- Çertifikatën e pronësisë së mjetit (në emër të AK)
- Lejen e qarkullimit të mjetit (në emër të AK)
- Çertifikatën e kontrollit teknik të mjetit (në emër të AK)
- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike (në emër të AK)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe konform Ligjit 8378 date 22.07.1998 sipas “Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar për të shmangur çdo parregullsi.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar , si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike

Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit:

Bazuar në nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në përlogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet të referohet një osë më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Grupi i Punës, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë blerje, ka organizuar punën dhe ka ndërmarrë hapa

konkret për secilën nga alternativat e përcaktuara në nenin 76 të VKM 285/2021 për llogaritjen e vlerës limit të kontratës (fondit limit), me qëllimin që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. ***Lidhur me këtë proces, grupi i punës ka argumentuar dhe dokumentuar bazuar pikës 1 germa “b” te nenit 76 te ligjit 162/2020 konkretisht:***

- ***Sa i përket respektimit të pikës “b”, Grupi i Punës, bazuar në rregullat e tregut, ka kryer studimin e tregut nëpërmjet marrjës së ofertave, për të njohur për aq sa është e mundur, nivelin e tregut aktual. Operatorët Ekonomik të përzgjedhur në mënyrë rastësore për marrjen e ofertave për testimin e tregut, janë subjekte tregtare të licënuara dhe të regjistruar pranë QKB dhe referuar objektit të veprimtarisë së tyre të publikuara në faqet on-line respektive, por edhe sipas Ekstraktit të Regjistrimit publikuar në faqen zyrtare on-line të QKB, rezultojnë se kanë në objektin e veprimtarisë së tyre, fushen objekt prokurimi.***

Të gjitha kriteret në mënyre më të hollësishme pasqyrohen në DST dhe konkretisht në Shtojcën 7 te **“KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT”**, qe ndodhen ne dosjen e tenderit objekt prokurimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK. Specifikimet teknike për artikujt e

kërkuar, përshkruajnë tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (neni 36), dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (neni 40 pika 2).

Parametrat teknike, Specifikimet, Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Objekti: Blerje mjete të ndryshme (kamionçina vetë-shkarkuese) për nevoja të Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit Tiranë.

1 – SPECIFIKIME TEKNIKE PËR KAMIONÇINË VETË-SHKARKUESE E MBYLLUR HERMETIKISHT (2 AKSE) PËR GRUMBULLIM MBETJESH ME KAPACITET 5M³ – 6M³.

- | | |
|---------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. Tipi i mjetit: | <i>Kamionçinë vet-shkarkuese e mbyllur hermetikisht me hapje anësore për grumbullim mbetjesh me kapacitet 5m³ – 6m³.</i> |
| 2. Viti i Prodhimit: | <i>≥ 2014 (vit prodhimi jo më herët se 2014)</i> |
| 3. Kilometra të përshkruara:
<i>kilometra</i> | <i>Jo më shumë se 70.000 (shtatëdhjetë mijë)
të përshkruara</i> |
| 4. Numri i akseve: | <i>(dy akse)</i> |
| 5. Lloji i lëndës djegëse: | <i>Naftë (Diesel)</i> |
| 6. Numri i vendeve: | <i>1+1</i> |
| 7. Kutia e shpejtësisë: | <i>Manual/Automatik</i> |
| 8. Standarti i Emetimit: | <i>jo më pak se EURO 5 (≤ EURO 5)</i> |
| 9. Numri i dyerve: | min 2 (dy) |
| 10. Lloji i dritareve: | <i>me komandë elektrike</i> |
| 11. Pesha maksimale e autorizuar (bruto): | <i>jo më shumë se 3600 kg</i> |
| 12. Pesha e mjetit bosh (neto): | <i>2000 - 2200 kg</i> |
| 13. Kapaciteti mbajtës (i ngarkesës) | <i>1200 - 1400 kg</i> |
| 14. Sistemi i drejtimit: | <i>Timon majtas</i> |
| 15. Sistemi i kondicionimit: | <i>Ajër i kondicionuar</i> |
| 16. Fuqia Motorrike: | <i>80-100 (kw)</i> |
| Dimesnionet e përgjithshme të mjetit: | |
| Gjatësia: | <i>min 500 – max 530 cm</i> |
| Gjerësia: | <i>min 210 - max 230 cm</i> |
| Lartësia: | <i>min 230 – max 250 cm</i> |

Të tjera specifikime teknike:

Kazani (kontenieri i meturinave vetë-shkarkues) i mbrapëm i automjetit duhet të jetë i përbërë nga material alumini jashtë dhe brënda (alumini rezulton një material rezistent ndaj korrozionit dhe ndryshkut), e manovrueshme (ulje-ngritje vertikale) me sistem elektrik kontrolli të integruar me mjetin, me kapacitet grumbullimi **5m³ – 6m³**.

Gjithashtu automjeti duhet të ketë këto opsione: Sistem frenimi kundër bllokimit (ABS) , sistem kundër rrëshqitjes, diferenciali i kontrolluar kundra rrëshqitjes, airbag krahu i shoferit, airbag pasagjeri, kompjuter në bord, Radio/CD Player, kontrolli i qëndrueshmërisë në rrugë, drita paralajmëruese (fenelina sinjalizuese).

Kërkesa të tjera:

Në momentin e dorëzimit, mjete të jetë i pajisur me:

- Gomë rezervë, krik, xhiromakinë.
- Trekëndësh sigurie dhe kuti të ndihmës së shpejtë.
- Certifikatë pronësie, leje qarkullimi, kolaudim, dhe policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjesinë ndaj paleve te treta (TPL), ne emer te bleresit ‘Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit’, këto me shpenzimet e subjektit ofertues.
- Garancia jo me pak se 12 muaj.
- Në garanci perfshihen te gjitha defektet qe nuk vijne si pasojë e drejtuesit te mjetit apo të mosmirëmbajtjes së tij.
- Cdo shmangie nga kërkesat e mesiperme eshte kusht skualifikues.
- Afati i levrimit, jo me shume se 15 ditë.

Ofertuesi do te pajiset nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit me autorizimin perkatës për të vepruar në lidhje me aplikimet dhe dhënien e dokumentacionit pranë DPSHTRR.

2 – SPECIFIKIME TEKNIKE PËR KAMIONCINË VETË-SHKARKUESE ELEKTRIKE E MBYLLUR HERMETIKISHT PËR GRUMBULLIM MBETJESH.

- | | |
|------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1. Tipi i mjetit: | <i>Kamionçinë vet-shkarkuese elektrike e mbyllur hermetikisht me hapje anësore për grumbullim mbetjesh.</i> |
| 2. Viti i Prodhimit: | <i>≥ 2016 (vit prodhimi jo më herët se 2016)</i> |
| 3. Kilometra të përshkruara:
<i>kilometra të përshkruara</i> | <i>Jo më shumë se 40 000 (dyzetë mijë)</i> |
| 4. Lloji i mjetit: | <i>Full Electric (100% Sistem Elektrik).</i> |
| 5. Gjëndja e Mjetit: | <i>Jo më shumë se 2700 orë pune.</i> |
| 6. Numri i vendeve: | <i>1+1</i> |
| 7. Kutia e Shpejtësisë: | <i>Automatik</i> |
| 8. Numri i dyerve: | min 2 (dy) |
| 9. Lloji i dritareve: | <i>me komandë elektrike</i> |
| 10. Pesha maksimale e autorizuar (bruto): | <i>min 1400 – max 1500 kg</i> |
| 11. Kapaciteti mbajtës (i ngarkesës): | |

- 12. Sistemi i drejtimit:** *Timon majtas*
13. Distanca midis akseve (nga rrota në rrotë): *190-200 cm*
14. Paketa e Baterisë: *Jo më e vogël se 17 – 19 kw*

Dimesnionet e përgjithshme të mjetit:

- Gjatësia:** *min 390 – max 410 cm*
Gjerësia: *min 120 – max 130 cm*
Lartësia: *min 190 – max 210 cm*

Të tjera specifikime teknike:

Kazani (kontenieri i meturinave vetë-shkarkues) i mbrapëm i automjetit duhet të jetë i përbërë nga material alumini jashtë dhe brënda (alumini rezulton një material rezistent ndaj korrozionit dhe ndryshkut), e manovrueshme (ulje-ngritje vertikale) me sistem elektrik kontrolli të integruar me mjetin, përmasat e koshit (kontenierit vetë-shkarkues duhet të jenë (gjatësi X gjerësi X lartësi) min 140-150cm x 120-130cm x 110 - 120 cm.

Kërkesa të tjera:

Sistem ngrohës me sedilje ngrohëse për shoferin dhe pasagjerin.

Extra-konvertues rryme.

Radio/CD Player

Fenelina sinjalizuese të vendosura sipër kabinës së auto-mjetit

Të jetë e pajisur me ushqyes baterie.

Në momentin e dorëzimit, mjete të jetë i pajisur me:

- Gomë rezervë, krik, xhiromakinë.
- Trekëndësh sigurie dhe kuti të ndihmës së shpejtë.
- Certifikatë pronësie, leje qarkullimi, kolaudim, dhe policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjesinë ndaj paleve të treta (TPL), në emër të bleresit 'Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit', këto me shpenzimet e subjektit ofertues.
- Garancia jo më pak se 12 muaj.
- Në garanci përfshihen të gjitha defektet që nuk vijnë si pasojë e drejtuesit të mjetit apo të mosmirëmbajtjes së tij.
- Cdo shmangie nga kërkesat e mesiperme është kusht skualifikues.
- Afati i levrimit, jo më shumë se 15 ditë.

Ofertuesi do të pajiset nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit me autorizimin përkatës për të vepruar në lidhje me aplikimet dhe dhënien e dokumentacionit pranë DPSHTRR.